

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**“HASAN PRISHTINA”**  
**FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT**



**PUNIMI I DIPLOMES – MASTER**

NDIKIMI I DISA KARAKTERISTIKAVE MORFOLOGJIKE DHE  
LËVIZORE BAZIKE NË ATO SITUACIONALE TEK  
HENDBOLLISTËT E RINJË AKTIV DHE JOAKTIV TË MOSHËS 14-15  
VJEÇE

**Mentori:**  
Dr. Ass. Afrim Koca

**Kandidati:**  
Alban Nuhiu

Prishtinë, 2016

# PËRMBAJTJA

<b>1. HYRJE .....</b>	<b>3</b>
1.2. <i>HULUMTIMET E GJERTANISHME.....</i>	8
<b>2. PROBLEMI, LËMIA, QËLLIMI DHE DETYRAT .....</b>	<b>12</b>
<b>3. HIPOTEZAT THEMELORE .....</b>	<b>13</b>
<b>4. METODOLOGJIA E PUNËS.....</b>	<b>14</b>
4.1 <i>MOSTRA E ENTITETIT / TË TESTUARËVE/ .....</i>	14
4.2 <i>MOSTRA E NDYSHOREVE .....</i>	14
4.2.1 <i>Ndryshoret e pavarura antropometrike .....</i>	14
4.2.2 <i>Ndryshoret e pavarura lëvizore bazike .....</i>	14
4.2.3 <i>Ndryshoret e varura lëvizore situacionale .....</i>	15
4.3. <i>TEKNIKA E MATJES .....</i>	16
4.3.1 <i>Teknika e matjes të parametrave antropometrik.....</i>	16
4.3.2 <i>Teknika e matjes të parametrave lëvizore bazike.....</i>	22
4.3.3 <i>Teknika e matjes të parametrave lëvizore situacionale .....</i>	28
4.4. <i>METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE .....</i>	34
<b>5. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUTIMI.....</b>	<b>35</b>
5.1. <i>PARAMETRAT THEMELOR STATISTIKOR TË PARAMETRAVE ANTROPOMETRIK, LËVIZORE BAZIKE DHE SITUACIONALE HENDBOLLISTËT E RINJË AKTIV DHE JOAKTIV TË MOSHËS 14-15 VJEÇE.....</i>	35
5.2. <i>REZULTATET E NDËRLIDHJEVE NDËRMJET NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE, LËVIZORE BAZIKE DHE SITUACIONALE .....</i>	39
<b>5.3 ANALIZA REGRESIVE E PARAMETRAVE ANTROPOMETRIK DHE LËVIZOR BAZIK ME ATA SPECIFIKE LËVIZORE.....</b>	<b>42</b>
5.3.1 <i>Ndikimi i ndryshoreve antropometrike dhe lëvizore bazike në udhëheqjen e topit me shpejtësi 40 metra (MSUT40).....</i>	42
5.3.2 <i>Ndikimi i ndryshoreve antropometrike dhe lëvizore bazike në udhëheqjen e topit me shpejtësi 40 metra (MSUT40).....</i>	44
5.3.3 <i>Ndikimi i ndryshoreve antropometrike dhe lëvizore bazike në gjuajtjen nga vendi e 10 topave në portë 50x50cm nga 9 metra (GJVTOP) .....</i>	46
5.3.4 <i>Ndikimi i ndryshoreve antropometrike dhe lëvizore bazike në gjuajtjen nga vendi e 10 topave në portë 50x50cm nga 9 metra (GJKTOP).....</i>	48
5.3.5 <i>Ndikimi i ndryshoreve antropometrike dhe lëvizore bazike në vrapim tri herë rreth 9m me tri gjuajtje (VR33GJ).....</i>	50
5.3.6 <i>Ndikimi i ndryshoreve antropometrike dhe lëvizore bazike në gjuajtjen e topit në mur brenda një minute (GJTM1M) .....</i>	52
5.4. <i>VËRTETIMI I HIPOTEZAVE .....</i>	54
<b>6. PËRFUNDIMI .....</b>	<b>55</b>
<b>7. RËNDËSIA TEORIK DHE PRAKTIK .....</b>	<b>57</b>
<b>8. LITERATURA .....</b>	<b>58</b>

## 1. HYRJE

Angazhimi i rinisë në lojën e hendbollit mund të ndikojë në formësimin personalitetit të tyre, veçanarisht në karakteristikat e tyre morale dhe sociale. Nëpërmjet lojës së hendbollit të rejtat formojnë dhe përvetësojnë sistemin e vlerave, zhvillojnë dhe mësojnë disa tipare të personalitetit, sikur që janë: bashkëpunimi, këmbëngulësia, përgjegjësia; përvetësojnë disa rregulla të sjelljes dhe komunikimit, duke u pajtuar me ndryshime dhe formimin e shprehive të reja të jetesës.. Studime të shumta tregojnë angazhimi në sport është në korelacion negativ me format e padëshiruara të sjelljeve p.sh. delikuenca (Barnett, Smoll dhe Smith, 1992).

Hulumtimet e shumta shkencore sidomos të viteve të fundit kanë vërtetuar dhe shpjeguar rendësin e madhe që kanë karakteristikat morfologjike dhe përgatitja kondicionalë si faktor i cili në masë të madhe determinon suksesin në lojën e hendbollit. Rezultatet e larta kulmore mund të parashikohen dhe të arrihen vetëm gjatë një procesi stërvitor të gjatë (nga mosha më e hershme) dhe e organizuar mirë, i cili i është nënshtruar ligjeve të zhvillimit bio-psiko-social si dhe stimuluesve stërvitor të mundshëm dhe të nevojshëm për zhvillimin dinamik të aftësive bazike dhe specifike, cilësive dhe njohurive të hendbollistëve. Për çdo sport është e domosdoshme që të bëhet periodizimi i punës dhe programi i përgatitjes kondicionalë duke i respektuar specifikat e lojës së hendbollit, respektivisht, duhet të zhvillojmë ata faktorë të cilët më së tepërmi do të kontribuojnë në suksesin e përgjithshëm tek loja e hendbollit. Për optimalizimin e procesit të përgatitjes sportive hulumtuesit sportiv si dhe ekspertët e ndryshëm tentojnë të grumbullojnë sa më tepër informacione për aktivitetin konkret sportiv si dhe mbi strukturën e kërkuar të karakteristikave antropologjike të sportistit. Hendbolli është sport kompleks të cilën e përbëjnë lëvizjet komplekse të thjeshta dhe të përbëra, dhe se këto lëvizje i ekzekutojnë anëtarët e ekipit në kushtet e bashkëpunimit si dhe kundërvënies ekipit kundërshtarë gjatë lojës. Me përjashtim, duhet pasur parasysh në gjendjen e aftësive motorike dhe motorike-situacionale si dhe në karakteristikat morfologjike të hendbollistëve të rinj. Meqenëse hendbolli është sport kompleks, parashtrihen kërkesa dukshëm të mëdha në këto karakteristika antropologjike të përmendura. Përpos vërtetimit të kontributit të çdo karakteristike antropologjike është me

rëndësi të vërtetojmë edhe raportet optimale në mes të gjitha karakteristikave, me ç'rast fitohen informacionet mbi përgatitjen integrale të hendbollistit.

Në kohën e fundit, gjithë e më tepër është e qartë se garat sportive moderne gjithnjë e më tepër duke kërkuar nga hendbollistët që ata të jenë në aspektin antropologjik të përzgjedhur mirë dhe ti përshtaten lojës në aspektin morfologjik, të jenë të qëndrueshëm: që shpejt të perceptojnë, të gjykojnë raportet e rëndësishme dhe të marrin vendime gjatë lojës, të koncentrohen, të kontrollojnë emocionet e tyre, të përshtaten në përgatitjet kondicionalë dhe të përshtaten me situatën gjatë lojës, që gjatë gjithë lojës të mbajë nivelin e veprimit optimal në përputhje me rregullat dhe kërkesat që kërkohen, varësisht nga konkurrenca dhe rëndësia e lojës. Përshtypja jonë është se hendbollistët shumë më shumë janë të harmonizuar në atë që mund të jenë të përgatitur fizikisht si dhe në aspektin taktike dhe teknike, se sa në aspektin e asaj se cilat janë kufijtë psikik të qëndrueshmërisë. Autorët amerikanë zakonisht me përgatitje kondicionalë nënkuptojnë përdorimin e metodave dhe teknikave të caktuara të tilla si: përgatitja e qëndrueshmërisë anaerobe dhe aerobe, teknike, taktike, kontrolli emocional, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e vetë-besimit, si dhe zhvillimit të arritjes së motivimit gjatë lojës. Rëndësia që i atribuohet suksesit në lojën e hendbollit gjithnjë e thekson lidhjen e saj me strukturën e përgatitjes psikologjike të hendbollistit. Kjo buron nga fakti se hendbollistët në rangjet e njëjta të garimit kryesisht janë të barabartë në shumë elemente relevante të përgatitjes sportive (fizike, teknike, motorike, taktike ...) kështu që faktorët psikologjikë shpesh luajtën një rol vendimtar. Për një trajner që punon me hendbollist dhe hendbollistë të reja (të moshës së adoleshencës së re) është veçanërisht e rëndësishme që të krijojë një marrëdhënie korrekte me prindërit hendbollistëve të rinj. Prindi është një faktor që në masë të madhe mund të kontribuojë rritjen e rezultateve sportive në lojën e hendbollit. Megjithatë, në disa raste, ambiciet e tepërta të prindërve (të padurueshëm) mund të ndikojë në aspektin kufizues në zhvillimin e hendbollistëve të rinj. Prandaj, një vëmendje e veçantë në stërvitjet e hendbollistëve të gjitha moshave duhet t'i kushtohet përgatitjes psikologjike. Nga e gjithë kjo që u tha, sidomos duke pasur parasysh faktorët antropologjik si dhe të mësuarit e elementeve teknike dhe taktike të lojës, pastaj tipareve të personalitetit të rëndësishme për suksesin në lojën e hendbollit, motivimin, dhe mekanizmat psiko-sociale të ndërveprimit në grupin hendbollistëve, është e qartë se

seleksionimi i mirë, përgatitja e përgjithshme së bashku me përgatitjen tekniko-taktike dhe fizike qon në arritjen e sukseseve të larta në lojën e hendbollit.

Periudha e rritjes dhe zhvillimit të organizmit të adoleshentët është periudha më e ndjeshme ndaj ndikimit të aktiviteteve të ndryshme fizike që shkaktojnë ndryshime të shumëfishta në karakteristikat morfologjike dhe në përmirësimin e aftësive motorike dhe funksionale. Pikërisht, kjo është arsyeja pse komponent e përbërjes antropologjike duhet të jenë përherë në harmoni me kërkesat e lojës së sportit konkret (De Vris, 1976)

Aktiviteti fizik komplekse ku bënë pjesë edhe loja e hendbollit si një fenomen social ndikon pozitivisht në zhvillimin aftësive dhe veçorive antropologjike të njeriut. Përmbytja, lloji i ushtrimeve si dhe intenziteti dhe ekstenziteti i ekzekutimit ndikojnë në ruajtjen dhe avansimin e shëndetit, e sidomos në mbajtjen e peshës ideale e që do të thotë një raport në mes masës yndyrore dhe asaj joindyrore.

Nga të gjitha karakteristikat antropologjike ku bëjnë pjesë veçoritë morfologjike, konative, aftësive motorike, kognitive, funksionale disa karakteristika psikologjike dhe sociologjike, dy karakteristikat antropologjike; statusi morfologjike dhe motorik janë një nga faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në lojën e hendbollit. Faza e rritjes dhe zhvillimit të organizmit është periudha më e ndjeshme ndaj ndikimit të aktiviteteve të ndryshme fizike që shkaktojnë ndryshime të shumëfishta pozitive në karakteristikat morfologjike dhe në përmirësimin e aftësive motorike të cilat kanë një rëndësi të veçantë në arritjen e suksesit në lojën e hendbollit, me kusht që këto karakteristika morfologjike dhe aftësi motorike të jenë të aplikuara në mënyrë të drejtë.

Shumica e aftësive motorike fitohen dhe zhvillohen kryesisht në periudhën e fëmijërisë. Në këtë periudhë të zhvillimit ndërtohet dhe zhvillohet struktura e hapësirës motorike, ndërsa pas periudhës së pubertetit (14 – 16 vjeçare), fillon të stabilizohet (Metikoš me bp., 1974; Kurelič me bp., 1975; Bala, Kiš dhe Popovič, 1996).

Në këtë fazë të zhvillimit me sukses i përvetësojnë elementet e teknikës sportive duke i ekzekutuar me një intensitet më të lartë, dhe se në këtë periudhë është e nevojshme një proces stërvitor më i avancuar.

Nga, gati të gjitha karakteristikat antropologjike ku bëjnë pjesë veçoritë konative, aftësive kognitivih, funksionale disa karakteristika psikologjike dhe sociologjike, dy karakteristikat antropologjike; statusi morfologjike dhe motorik janë një nga faktorët më të rëndësishëm stimulues dhe me veprim restriktiv në paraqitjen dhe, natyrisht, zgjedhjen dhe suksesin në hendboll.

Rritja dhe zhvillimi i shpejtë i organizmit është periudha më e ndjeshme ndaj ndikimit të aktiviteteve të ndryshme fizike që shkaktojnë ndryshime të shumfishta në karakteristikat morfologjike dhe në përmirësimin e aftësive motorike.

Në përputhje me rrethanat, është e arsyeshme të thuhet se karakteristikat antropometrike dhe aftësitë motorike adekuate të sportistëve mundësojnë që të arrihen rezultate të favorshme në disiplinat e angazhuara. Shumica e aftësive motorike fitohen dhe zhvillohen kryesisht në periudhën e fëmijërisë. Në këtë periudhë të zhvillimit ndërtohet dhe zhvillohet struktura e hapësirës motorike, ndërsa pas periudhës së pubertetit (14 – 16 vjeçare), fillon të stabilizohet (Metikoš, 1974, Kurelič me bashk., 1975, Bala, Kiš dhe Popovič, 1996).

Në këtë fazë të zhvillimit me sukses i përvetësojnë elementet e teknikës sportive duke i ekzekutuar me një intensitet më të lartë, dhe se në këtë periudhë është e nevojshme një proces stërvitor më i avancuar (Duraškovic, 2002).

Mosha e re shkollore, shikuar në përgjithësi, përfaqëson një periudhë jashtëzakonisht të ndjeshme për zhvillimin motorik të fëmijëve, sidomos kur është fjala të mësuarit dhe përvetësimi i repertorit të gjerë të aftësive motorike. Është shumë e rëndësishme të mos humbet kjo periudhë, respektivisht përparësitë të cilat i bartë në formimin e bazës motorike. Për zhvillimin e fëmijës në këtë moshë, por edhe në moshën më të re me rëndësi të madhe është përzgjedhja e aktiviteteve të duhura lëvizore (Popovič, B. 2010).

Që të mund të vlerësohet dhe matet ndonjë aksion i njeriut në hapësirën motorike dhe lidhshmërinë e saj me karakteristikat tjera antropologjike sidomos kognitive është e domosdoshme që këtë strukturë ta identifikojmë. Është e natyrës që ndryshoreve motorike së bashku me aftësitë kognitive si dhe ato tjera duhet të jenë në ndonjë

korrelacion të caktuar. Niveli dhe vlerat e këtyre raporteve dhe lidhjeve gjerë më tani nuk janë hulumtuar në nivelin e kënaqshëm.

Ndikimi i faktorëve morfologjik dhe motorik në ata motorik specifik paraqet një segment të rëndësishëm të preokupimit të shumë hulumtuesve sportiv. Prandaj edhe ky punim do të jetë një përpjekje që të rris njohuritë mbi rëndësinë e faktorëve morfologjik dhe motorik në realizimin e shumë detyrave motorike specifike të rëndësishme për lojën e hendbollit.

## **1.2. HULUMTIMET E GJERTANISHME**

Një nga drejtimet e hulumtimeve në hendboll është dhe përcaktimin karakteristikave antropologjike dhe e përgatitjes kondicionalë të hendbollistëve të rinj të gjinisë mashkullore dhe femërore. Një problem i veçantë paraqet analizimi i dallimeve

në mes të grupeve të hendbollistëve të moshave dhe gjinive të ndryshme në hendboll . Kjo është e rëndësishme sepse në bazë të diferencës së fituar mund të përcaktojmë ngecje të caktuar në treguesit e zhvillimit morfologjik dhe motorik ose kondicional të trajnimit të hendbollistët e rinj. Të vërejturit e dobësive në këto karakteristika duhet të korrigjohet brenda një periudhe të caktuar dhe sa më të afërt ashtu që ti afrohem nivelit të modelit i cili më parë është planifikuar ose vlerat referuese në aftësitë deficitare nga të cilat varet sukcesi i lojës. Në këtë kuptim, është projektuar ky studim sepse pritet të arrihen të dhëna mbi rëndësinë e diferencës midis nxënësve sipas gjinisë në disa karakteristika morfologjik dhe motorik të rëndësishëm për lojën e hendbollit.

**Klojçnik, A. (1977)**, ka bërë hulumtime me qëllim që të vërtetohet "Ndikimi i disa sporteve (atletika, volejboli, hendbolli, gjimnastika sportive, basketbolli, futboli dhe noti) në disa dimensione të statusit psikosomatik dhe ndikimi që paraqitet si diferencë midis sporteve". Hulumtimi është bërë me nxënësit e shkollës fillore prej kl. V - VIII. Mostra e grupit eksperimental ka pasur 795 nxënës, kurse grupi kontrollues 656 nxënës. Rezultatet e hulumtimit kanë treguar se eksperimenti i mësimin njëvjeçar ka pasur ndryshime të rëndësishme pozitive në statusin psikosomatik në mënyrë specifike. Gjatë përpunimit të rezultateve është aplikuar metoda e analizës univariante të variancës dhe kovariancës dhe metoda e analizës diskriminuese.

**Hofman, E. (1980)**, në mostrën prej 684 entiteteve të gjinisë mashkullore, të moshës 19 – 27 vjeçare ka aplikuar 13 teste për vlerësimin e shpejtësisë së lëvizjeve dhe 23 masa antropometrike, rezultatet e fituara janë trajtuar me analizën korelative kanonike. Pas analizës janë fituar katër faktorë, struktura e të cilëve mundëson supozimin për ndikimin negativ të masave inerte frenuese në arritjen e suksesit në testet e shpejtësisë së lëvizjeve të thjeshta dhe efekt stimulues për sukses në testet e frekuencës së lëvizjeve, që çon deri te përfundimi se statusi antropometrik qartë i diferencon testet e shpejtësisë së lëvizjeve në dy grupe. Karakteristikat biomekanike të testeve të nën hapësirës motorike, e cila ka të bëjë me shpejtësinë e thjeshtë dhe karakteristikat anatomike në kuadër të masave antropometrike, po ashtu janë shkak i rëndësishëm për manifestimin e lidhshmërisë kanonike të dy nën hapësirave të statusit antropologjik



**Çitaku, F., (1981)**, ka bërë hulumtime në hapësirën motorike në segmente të forcës, shpejtësisë dhe saktësisë. Këto hulumtime i ka realizuar me 118 sportistë aktivë (hendbollistë, basketbollistë dhe volejbollistë) të Ligës së Kosovës dhe asaj federative. Qëllimi themelor i këtij hulumtimi ka qenë përcaktimi i strukturës faktoriale të ndryshoreve të zbatuara, përcaktimi i ndërlidhjeve faktoriale në hapësirën manifeste dhe latente, varësisht nga tri grupet e sportistëve. Në bazë të analizës së të dhënave janë emërtuar katër faktorë të rëndësishëm:

- faktori i parë është definuar si kombinim i forcës repetitive dhe statike,
- □ faktori i dytë është definuar si forcë eksplozive;
- □ faktori i tretë është emërtuar si kombinim i forcës statike në radhë të parë dhe si forcë repetitive në rend të dytë.

Është konstatuar se preciziteti nuk është ekstrahuar si faktor. Ndryshoret e aplikuara të hapësirës bazike motorike nuk diferencojnë sportistët në grupe.

**Gjinolli, E., (1982)**, ka publikuar hulumtimin " Ndikimi i programeve të ndryshme të procesit mësimor të edukimit fizik në disa dimensione të statusit psikosomatik të nxënësve të klasës së pestë të shkollës fillore". Qëllimi kryesor i hulumtimit ka qenë përcaktimi i ca dimensioneve antropometrike dhe motorike të nxënësve të klasave të pesta të shkollave fillore të Shkupit dhe Gjilanit, që kanë mundur të paraqiten nën ndikimin e programeve jo të harmonizuara të edukimit fizik në ato shkolla. Mostra e entiteteve ka përfshirë 150 nxënës nga Shkupi dhe 150 nga Gjilani. Janë aplikuar 3 teste të hapësirës antropometrike dhe 7 ndryshore të hapësirës motorike. Me qëllim të krahasimit të rezultateve janë bërë dy matje gjatë vitit shkollor. Me analizën e rezultateve të fituara, në fillim të vitit shkollor 1977/78 dhe në mbarim të vitit shkollor, ndryshimet antropometrike dhe motorike kanë qenë në favor të nxënësve nga Shkupi.

**Çitaku, F., (1985)**, në tezën "Struktura latente e precizitetit" ka bërë hulumtime me nxënësit e shkollave të mesme të moshës 18 - 20 vjeçare në komunën e Lipjanit, të Pejës dhe Podujevës. Mostra e ndryshoreve ka përfshirë gjithsej 32 ndryshore të precizitetit motorik. Ndërkaq, mostra e entiteteve ka pasur 436 nxënës. Qëllimi themelor i

hulumtimit ka qenë konstatimi i strukturës primare latente të precizitetit. Në bazë të analizës faktoriale të strukturës së precizitetit janë vërtetuar tri nivele të strukturës latente të precizitetit.

**Haklaj, M., (1985)**, me ndihmën e dy grupeve të nxënësve të moshës 16 vjeçare të dy mjediseve të ndryshme, ka bërë vlerësimin e ca karakteristikave motorike të tri testeve, që hipotetikoisht matin fleksibilitetin dhe ka konstatuar se besueshmëria e tri testeve është e lartë (.98). Të gjitha thërmiat e çdo instrumenti i takojnë hapësirës së përbashkët manifeste. Më tej ka përkufizuar hapësirën faktoriale të testeve të aplikuara, me ç'rast ka izoluar dy faktorë:

- faktorin përgjegjës për fleksibilitetin e shumë nyjeve dhe
- faktorin për fleksibilitetin e kërdhokullave

**Aliu, M. (1991)**, në punimin "Zhvillimi morfologjik dhe disa karakteristika motorike të popullatës dhe diferenca në ato karakteristika kronologjike të moshës së caktuar", ka hulumtuar zhvillimin dhe diferencat në dimensionet antropometrike dhe aftësive motorike, si në hapësirën manifeste ashtu edhe në atë latente të nxënësve të moshave 15 - 17 vjeçare.

**Gjinolli, E. (1997)**, në punimin e tij "Karakteristikat antropometrike dhe motorike të vlefshme për volejball të nxënësve të klasës së pestë fillore", ka izoluar dy faktorë antropometrikë: faktorin e parë e ka interpretuar si dimensionaliteti longitudinal dhe transversal i skeletit; ndërsa të dytin si faktor i masës, perimetrit dhe indit dhjamor nën lëkuror. Ndërsa, në hapësirën motorike ka ekstrahuar tre faktorë të cilët i ka emërtuar si:

- Faktori i forcës eksplozive;
- Faktori i forcës statike, fleksibilitetit dhe ekulibrit dhe
- Faktori i frekuencës së shpejtësisë së lëvizjeve themelore dhe agjilitetit.

**Savic, B., Dragan. D. (2006)** në hulumtimin e tyre përshkruan dallimet në karakteristikat antropometrike ndërmjet dy reprezentacioneve të femrave në hendbollit asaj të vitit 1984 dhe 2001 të ish Jugosllavisë. Rezultatet tregojnë për ndryshime në

parametrat e volumenit trupor dhe të indit dhjamor në favor të ekipes së vitit 1984. Hendbollistet e reprezentacionit të vitit 2001 në raport me vitin 1984 kanë pasur legen më të gjerë, perimetër me te madh të gjoksit, të nën llërës dhe kofshës, dhe më pak ind dhjamor nën lëkuror të ekstremiteteve të epërme.

**Në hulumtimin Oxyzoglou, N., Ore, G., Rizos, S. (2009)** Department of Physical Education and Sports Science, Aristotle University of Thessalonica, Serres, Greece, është vërtetuar dallimi në disa karakteristika antropometrike dhe motorike tek hendbollistet profesional të Serbisë dhe Greqisë.

## 2. PROBLEMI, LËMIA, QËLLIMI DHE DETYRAT

Njohurit mbi zhvillimin dhe ndikimin e parametrave antropometrik dhe motorik të forcës eksplozive në parametrat situacional te hendbollistët paraqesin një ndër preokupimet kryesore të cilat duhet definuar.

**Problemi** i këtij hulumtimi paraqet analizimin i disa parametrave longitudinal antropometrik dhe motorik të tipit të forcës eksplozive eksploziv dhe precizitetit situacional në lojën e hendbollit. Problemi i cili trajtohet në këtë punim është i një rëndësie të veçantë, sepse nga rezultatet e fituara mund të vlerësojmë dhe të kemi një pasqyrë reale të ndikimit të këtyre faktorëve në realizimin e detyrave motorike specifike në lojën e hendbollit.

**Lëmia** e hulumtimit paraqet veçorit e dimensioneve antropometrike, aftësive motorike bazike dhe atyre situacional në lojën e hendbollit.

**Qëllimi** i këtij punimi është të përcaktohet niveli i ndikimit të parametrave longitudinal antropometrik dhe lëvizor bazike të karakterit të forcës eksplozive në ekzekutimin e detyrave lëvizore situacionale në lojën e hendbollit.

**Detyrat** – Për realizimin e qëllimit të parashtruar, janë parashtruar këto detyra të hulumtimit:

- Të përcaktohet niveli i zhvillimit të dimensioneve antropometrike longitudinale te hendbollistët.
- Të përcaktohet niveli i zhvillimit të aftësive motorike bazike, konkretisht, i forcës eksplozive.
- Të përcaktohet niveli i ndërlidhjeve brenda grupit sipas instrumenteve matëse.
- Të përcaktohet niveli i ndikimit të parametrave longitudinal antropometrik dhe motorike të forcës eksplozive në realizimin e detyrave specifike në hendboll.

### 3. HIPOTEZAT THEMELORE

Në harmoni me qëllimin e hulumtimit janë parashtruar këto hipoteza në mënyrë alternative:

**H1-** Rezultatet e fituara nga matjet e parametrave antropometrik longitudinal, lëvizore bazike dhe situacionale do të kenë shpërndarje normale.

**H2** – Koeficientët e interkorelacionit në mes ndryshoreve antropometrike longitudinale do të jenë në aspektin statistikor të rëndësishëm në nivel të propabilitetit  $p=0.05$ .

**H3** – Koeficientët e interkorelacionit në mes ndryshoreve lëvizore bazike të forcës eksplozive do të jenë në aspektin statistikor të rëndësishëm në nivel të propabilitetit  $p=0.05$ .

**H4** – Koeficientët e interkorelacionit në mes ndryshoreve lëvizore situacionale do të jenë në aspektin statistikor të rëndësishëm në nivel të propabilitetit  $p=0.05$ .

**H5** – Parametrat antropometrik longitudinal dhe lëvizore bazike si ndryshore prediktore do të kenë ndikim të rëndësishëm statistikor në ekzekutimin e detyrave lëvizore situacionale në nivel të propabilitetit  $p=0.05$ .

## 4. METODOLOGJIA E PUNËS

### 4.1 MOSTRA E ENTITETIT / TË TESTUARËVE/

Popullata nga e cila do të merret mostra e të testuarve është definuar si popullatë e nxënësve të përfshirë në seksionin shkollor të lojës së hendbollit. Mostra ka përfshirë 30 nxënës të SHMU "Skënderbeu" ne Përlepnice, aktiv në seksionin shkollor në lojën e hendbollit dhe 30 nxënës joaktiv të moshës 14-15 vjeçare. Nxënësit janë testuar në sallën e edukatës fizike pranë kësaj shkolle. Matjet antropometrike janë bërë në orët e paradites, ndërsa ato motorike bazike dhe motorike specifike në orët e pas ditës. Testimi ka përfunduar në fillim të muajit maj të vitit 2016.

### 4.2 MOSTRA E NDYSHOREVE

#### 4.2.1 Ndryshoret e pavarura antropometrike

Për matjen e zhvillimit morfologjik të hendbollistëve janë aplikuar ndryshoret:

Nr.	Shkurtesa	Kuptimi
1	ALARTË	Lartësia e trupit
2	AGJEKR	Gjerësia e krahëve
3	AGJASH	Gjatësia e shuplakës
4	AGJESH	Gjerësia e shuplakës
5	AGJKËM	Gjatësia e këmbës
6	AGJSHP	Gjatësia e shputës

#### 4.2.2 Ndryshoret e pavarura lëvizore bazike

Për vlerësimin e aftësive motorike bazike (Kurelić me bp., 1975) janë aplikuar 6 ndryshore:

Nr.	Shkurtesa	Kuptimi
1	MKGJVE	Kërcim së gjati nga vendi
2	MKLAVE	Kërcim së larti nga vendi
3	MCLKED	Kërcim së larti nga vendi me këmbën e djathtë
4	MCLKEM	Kërcim së larti nga vendi me këmbën e majtë.
5	MHTMKO	Hedhja e topit medicinal mbi kokë.
6	MHTMGJ	Hedhja e topit medicinal në nivel të gjoksit.

#### 4.2.3 Ndryshoret e varura lëvizore situacionale

Për vlerësimin e aftësive motorike situacionale janë përfshirë ndryshoret të cilat në shumë punime kanë treguar karakteristika metrike të mira:

Nr.	Shkurtesa	Kuptimi
1	MSUT40	Udhëheqja e topit me shpejtësi 40 metra
2	MSUS20	Udhëheqja e topit zigzag (sllallom) me shpejtësi 20 metra
3	GJVTOP	Gjuajtja nga vendi i 10 topave në portë 50x50cm nga 9 metra.
4	GJKTOP	Gjuajtja nga kërcimi i 10 topave në portë nga 9 metra
5	VR33GJ	Vrapim tri herë rreth 9m me tri gjuajtje
6	GJTM1M	Gjuajtja e topit në mur brenda një minute

## 4.3. TEKNIKA E MATJES

### 4.3.1 Teknika e matjes të parametrave antropometrik

Ndryshoret antropometrike janë matur sipas mënyrës siç vijon:

**1. Lartësia e trupit (ALARTË)** – matet me antropometër, entiteti që matet duhet të jetë i zbathur në brekë sportive të qëndroj në bazë të fortë horizontale. Koka e tij duhet të jetë në pozitë ku duhet respektuar horizontalja e frankfurtit. Qëndrimi i trupit te entitetit duhet te jetë i relaksuar dhe i drejt, ndërkaq matësi qëndron ne anën e majtë te entitetit. Pasi qe e kontrollon pozitën e entitetit dhe te instrumentit (antropometrit) , e lëshon krahun horizontal te antropometrit deri ne pjesën parietale të kokës (pika me e lart e kokës – vertex). Rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.

*Foto 1. Lartësia e trupit*





**2. Gjatësia e krahëve të shtrirë ( AGJAKR)** - matet me antropometër i testuari qëndron me duar të hapura horizontalisht në nivel të krahëve, dhe me shuplaka të kthyer përpara . matja kryhet nga daktilioni (maja e gishtit më të gjatë) i dorës së djathtë deri tek daktilioni i dorës së majtë, rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.

*Foto 2. Gjerësia e krahëve të shtrirë ( AGJAKR*



**3. Gjatësia e këmbës (AGJAKË)** – i testuari duhet të qëndroj sikurse në matjen e lartësisë së trupit, matje është kryer me antropometër të shkurtuar nga dyshemeja ku qëndron entiteti deri te pika e quajtur “gjembi i sipërm i përparem i çapokut” në anën e majtë të këmbës. Rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.

*Foto3. Gjatësia e këmbës (AGJAKË)*



**4. Gjatësia e shuplakës (AGJASH)** – matet me kompas rrëshqitës dhe atë ne dorën aktive. T testuari qëndron me krah të mbështetur për trupi , njeri krah i instrumentit vendoset ne matjen e gishtit të mesëm ( digitus madius ) ndërsa krahu tjetër i instrumentit të vija ndërmjet radiusit dhe ullnes .

*Foto 4. Gjatësia e shuplakës (AGJASH)*



**5. Gjerësia e shuplakës ( AGJESH )** – matja kryhet në dorën (shuplakën) aktive të fëmijës, matet me kompasin rrëshqitës dhe matet distanca në mes të gishtit të madh dhe ati te vogël të dorës.

*Foto 5. Gjerësia e shuplakës ( AGJESH*



**6. Gjatësia e shputës (AGJSHP)** – matet me kompas rrëshqitës, i maturi qëndron ulur me këmbën e majtë të mbledhur që formon këndin e drejt dhe me shputë të vendosur në dysheme. Matësi i vendos krahët e kompasit rrëshqitës në thembër dhe në gishtin më të gjatë. Rezultati lexohet me saktësi prej 0.1 cm.

*Foto 6. Gjatësia e shputës( AGJSHP)*



#### 4.3.2 Teknika e matjes të parametrave lëvizore bazike

Matja e testeve motorike-bazike është ekzekutuar sipas kësaj renditje:

##### 1. Kërcim së gjati nga vendi – MKGJVE

**Instrumentet:** Metri metalik, shtegu për vrapim kërcim së gjati.

**Përshkrimi i detyrës:**

**Pozita fillestare:** I testuari vendoset me shputa në dysheme, në fytyrë nga drejtimi i kërcimit.

**Realizmi i detyrës:** I testuari në përkulje të vogël në gjunjë duke e shfrytëzuar edhe hovin e krahëve, realizon kërcimin me të dy këmbët para. Detyra përsëritet tri herë, ndërkaq shënohet rezultati më i mirë.

**Vlerësimi:** Shënohet rezultati i kërcimit më të gjatë nga vendi i shtytjes deri të gjurmët e pjesës së pasme të shputave në saktësi 1 cm.

**Udhëzime të testimit:** Kërcimi përsëritet nëse i testuari kërcen në vend para kërcimit para, nëse kërcimi realizohet në një këmbë, nëse pas rënies mbështetet prapa në duar etj.

*Foto 7. Kërcim së gjati nga vendi – MKGJVE*



## 2. Kërcim së larti nga vendi – MKLAVE

**Instrumentet:** Metri metalik i vendosur në dy anët e murit për kërcim. Lartësia në mur është shënuar me cm deri mbi 3 m. lartësi.

### **Përshkrimi i detyrës:**

**Pozita fillestare:** I testuari vendoset brinjazi pranë murit, shputat janë të vendosura në gjerësi të legenit. I testuari e ngrit dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalisht , kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjes së parë, i testuari kërcen vertikalisht në lartësi (tre tentime) lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

**Realizimi i detyrës:** I testuari e ngrit dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalisht, kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjes së parë , i testuari kërcen vertikalisht në lartësi (tre tentime). lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm. Rezultati shënohet me 1 cm.

**Vlerësimi:** lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

**Udhëzime të testimit:** Të testuarve udhëzimet iu janë dhënë gjatë demonstrimit

*Foto 8. Kërcim së larti nga vendi – MKLAVE*





### **3. Kërcim së larti nga vendi me këmbën e djathtë – MKLKED**

**Instrumentet:** Metri metalik i vendosur në dy anët e murit për kërcim. Lartësia në mur është shënuar me cm deri mbi 3 m. lartësi.

#### **Përshkrimi i detyrës:**

**Pozita fillestare:** I testuari vendoset brinjazi pranë murit, shputat janë të vendosura në gjerësi të legenit.

**Realizimi i detyrës:** I testuari e ngrit dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalisht, kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjës së parë, i testuari kërcen vertikalisht në lartësi me këmbën e djathtë (tre tentime). lexohet rezultati më i mirë prej prekjës së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

**Vlerësimi:** lexohet rezultati më i mirë prej prekjës së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

**Udhëzime të testuarit:** Të testuarve udhëzimet iu janë dhënë gjatë demonstrimit të detyrës, se si duhet të kryhet detyra. E testuara bënë disa tentime provuese.

**Foto 9. Kërcim së larti nga vendi me këmbën e djathtë – MKLKED**





#### **4. Kërcim së larti nga vendi me këmbën e majtë – MKLKEM**

**Instrumentet:** Metri metalik i vendosur në dy anët e murit për kërcim. Lartësia në mur është shënuar me cm deri mbi 3 m. lartësi.

#### **Përshkrimi i detyrës:**

**Pozita fillestare:** I testuari vendoset brinjazi pranë murit, shputat janë të vendosura në gjerësi të legenit.

**Realizimi i detyrës:** I testuari e ngrit dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalisht, kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjës së parë, i testuari kërcen vertikalisht në lartësi me këmbën e majtë (tre tentime). lexohet rezultati më i mirë prej prekjës së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

**Vlerësimi:** lexohet rezultati më i mirë prej prekjës së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

**Udhëzime të testuarit:** Të testuarve udhëzimet iu janë dhënë gjatë demonstrimit të detyrës, se si duhet të kryhet detyra. I testuari bënë disa tentime provuese.

**Foto 10. Kërcim së larti nga vendi me këmbën e majtë – MKLKEM**



## 5. Hedhja e topit medicinal mbi kokë – MHTMK

**Instrumentet:** topi medicinal i peshës 2 kg, metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për hedhjen e topit medicinal

**- Përshkrimi i detyrës:**

**- Pozita fillestare:** I testuari qëndron në pozitë të drejtqëndrimit, fytyrë nga drejtimi i shtytjes së topit medicinal, me këmbë të zgjeruara në nivel të kërdhokullave dhe mban topin me dy duar të shtrira lartë mbi kokë.

**- Realizimi i detyrës:** I testuari nga pozita e drejtqëndrimit me fytyrë nga drejtimi i shtytjes hedhë topin medicinal sa ma larg që është e mundur. Detyra përsëritet dy herë. I testuari qëndron në pozitën e fundit që leximi të jetë sa më i saktë dhe të shikohet rregullsia e hedhjes.

**- Vlerësimi:** Shënohet rezultati i hedhjes e shënuar me centimetra. Pika zero është në fillim të hedhjes, saktësia e matjes 0,5 cm.

**- Udhëzime të testuarit:** Të testuarve iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës.

**Foto 11. Hedhja e topit medicinal mbi kokë – MHTMK**



## 6. Hedhja e topit medicinal në nivel të gjoksit – MHTMG

**Instrumentet:** topi medicinal i peshës 2 kg, metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për hedhjen e topit medicinal

- **Përshkrimi i detyrës:**

- **Pozita fillestare:** I testuara qëndron në pozitë të drejtqëndrimit, fytyrë nga drejtimi i shtytjes së topit medicinal, me këmbë të zgjëruara në nivel të kërdhokullave dhe mban topin me dy duar në nivel të gjoksit.

- **Realizimi** i detyrës: I testuara nga pozita e drejtqëndrimit me fytyrë nga drejtimi i shtytjes hedhë topin medicinal sa ma larg që është e mundur. Detyra përsëritet dy herë. I testuari qëndron në pozitën e fundit që leximi të jetë sa më i saktë dhe të shikohet rregullsia e hedhjes.

- **Vlerësimi:** Shënohet rezultati i hedhjes e shënuar me centimetra. Pika zero është në fillim të hedhjes, saktësia e matjes 0,5 cm.

- **Udhëzime të testuarit:** Të testuarve iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës.

*Foto 12. Hedhja e topit medicinal në nivel të gjoksit– MHTMGJ*



### 4.3.3 Teknika e matjes të parametrave lëvizore situacionale

#### 1. Udhëheqja e topit me shpejtësi 40 metra – MSUT40

**Instrumentet:** Metri metalik e gjatësisë 40m vendosur në tokë, topi i hendbollit me perimetër 56cm me peshe 450 gram.

**Përshkrimi i detyrës;**

**Pozita fillestare:** I testuari vendoset me shputa para vijës për udhëheqje, me fytyrë nga drejtimi të udhëheqjes.

**Realizmi i detyrës:** I testuari merr hov duke e udhëhequr topin, realizon udhëheqjen, me një dorë. Detyra përsëritet tri herë, ndërkaq shënohet rezultati më i mirë.

**Vlerësimi:** Shënohet shpejtësia e udhëheqjes së topit të hendbollit me saktësi 0.1sek.

**Udhëzime të testimit:** Udhëheqje përsëritet nëse i testuari udhëheq në mënyrë të pa rregullt.

*Foto 13. Udhëheqja e topit me shpejtësi 40 metra – MSUT40*



## **2. Udhëheqja e topit zigzag (sllallom) me shpejtësi 20 metra – MSUS20**

**Instrumentet:** Metri metalik e gjatësisë 20m vendosur në tokë, topi i hendbollit me perimetër 56cm me peshe 450 gram dhe 9 tapa të vendosura në çdo 2 metra.

**Përshkrimi i detyrës;**

**Pozita fillestare:** I testuari vendoset me shputa para vijës për udhëheqje, me fytyrë nga drejtimi të udhëheqjes.

**Realizmi i detyrës:** I testuari merr hov duke e udhëhequr topin zigzag, realizon udhëheqjen, me një dorë. Detyra përsëritet tri herë, ndërkaq shënohet rezultati më i mirë.

**Vlerësimi:** Shënohet shpejtësia e udhëheqjes së topit të hendbollit me saktësi 0.1 sek.

**Udhëzime të testimit:** Udhëheqje përsëritet nëse i testuari udhëheq në mënyrë të pa rregullt.

*Foto 14. Udhëheqja e topit zigzag (sllallom) me shpejtësi 20 metra – MSUS20*



### 3. Gjuajtja nga vendi i 10 topave në portë 50x50cm nga 9 metra – GJVTOP

**Instrumentet:** Topi i hendbollit me perimetër 56cm me peshe 450 gram, porta e ndarë në 9 pjesë, pjesa për gjuajtje **50x50cm në skajin e epërm.**

**Përshkrimi i detyrës;**


**Pozita fillestare:** I testuari vendoset me shputa para vijës për gjuajtje, me fytyrë nga drejtimi të portës nga largësia prej 9 metrave.

**Realizmi i detyrës:** I testuari 10 topa i gjuan me një dorë nga vendi në pjesën ose katrorin e epërm për gjuajtje 50x50cm të portës nga 9 metra.

**Vlerësimi:** Shënohet numri i gjuajtjeve të sakta në katrorin e epërm të portës 50x50cm.

**Udhëzime të testimit:** I testuar provon një herë testin para se ti numërohen pikët.

*Foto 15. Gjuajtja nga vendi i 10 topave në portë 50x50cm nga 9 metra – GJVTOP*



#### 4. Gjuajtja nga kërcimi i 10 topave në portë 50x50cm nga 9 metra – GJKTOP

**Instrumentet:** Topi i hendbollit me perimetër 56cm me peshe 450 gram, porta e ndarë në 9 pjesë, pjesa për gjuajtje 50x50cm në skajin e epërm, distanca 9 metra nga porta.

**Përshkrimi i detyrës;**


**Pozita fillestare:** I testuari vendoset me shputa para vijës për gjuajtje, me fytyrë nga drejtimi të portës nga largësia prej 9 metrave.

**Realizmi i detyrës:** I testuari 10 topa i gjuan me një dorë me hov nga kërcimi, në pjesën ose katrorin e epërm për gjuajtje 50x50cm të portës nga 9 metra.

**Vlerësimi:** Shënohet numri i gjuajtjeve të sakta në katrorin e epërm të portës 50x50cm.

**Udhëzime të testimit:** I testuar provon një herë testin para se ti numërohen pikët.

*Foto 16. Gjuajtja nga kërcimi 10 topave në portë 50x50cm nga 9 metra – GJKTOP*



## 5. Vrapim tri here rreth 9m me tri gjuajtje – VR33GJ

**Instrumentet:** Kronometri me 1/10 sek. Topi i hendbollit me perimetër 56cm me peshe 450 gram, porta dje distanca nga porta 9 metra.

### Përshkrimi i detyrës:


**Pozita fillestare:** I testuari përgatitet pranë vijës për start të ekzekutimit të detyrës, në pozitë të drejtqëndrimit. Vija e startit është te vija ku takohen vija e 9 metrave me vijën anësore. Në vijën e 9 metrave përballë vijës së 7 metrave vendosen në parket 3 rrethë me diametër 1 metër dhe në distancë prej 1 metër larg njëri-tjetrit.

**Realizimi i detyrës:** I testuari ka për detyrë që nga vija e startit të merr topin dhe të udhëheqë sa më shpejtë që është e mundur, të hyj në rreth dhe ta gjuaj në portë, të vazhdojë vrapimin deri te vija tjetër anësore ku takohen vija e 9 metrave dhe ajo anësore dhe kështu të vazhdojë vrapimin pa ndërprerë derisa t'i kryej tri gjuajtjet me top në portë.

**Vlerësimi:** Në fletë testim rezultatet shënohen me saktësi prej 0.1 sec.

**Udhëzime të testuarit.** Të testuarit udhëzohen që ta përsërisin dy here gjuajtjen si gjuajtje provuese.

*Foto 17. Vrapim tri here rreth 9m me tri gjuajtje – VR33GJ*





## 6. Gjuajtja e topit në mur brenda një minute – GJTM1M

**Instrumentet:** Kronometri me 1/10 sek. Topi i hendbollit me perimetër 56cm me peshe 450 gram , rekuizitat (shiriti metrik) për shënimin e gjatësisë dhe katrori 1 x 1 m në lartësi 1 m nga dyshemeje dhe në largësi prej 6 m nga .

**Përshkrimi i detyrës:**

**Pozita fillestare:** I testuari përgatitet për gjuajtje pranë vijës për gjuajtje në drejtqëndri.

**Realizimi i detyrës:** I testuari pa vrull dhe pa shkëputje nga vija e gjuajtjes , gjuan topin sa më shpejt në katrorin e vendosur në mur gjatësi prej 6 metrave.

**Vlerësimi:** Matet numri i gjuajtjeve të sakta të topit në katror brenda 1 minute.

**Udhëzime:** Të testuarit udhëzohen që ta përsërisin dy here gjuajtjen si gjuajtje provuese.

*Foto 18. Gjuajtja e topit në mur brenda një minute – GJTM1M*



#### 4.4. METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE

Në bazë të qëllimit dhe hipotezave të parashtruara, janë aplikuar metodat e përpunimit të rezultateve të cilat mundësojnë sigurimin e informatave të mjaftueshme për realizimin e qëllimit.

Për sistemin e ndryshoreve të karakteristikave morfologjike, lëvizore bazike dhe motorike situacionale janë llogaritur parametrat themelorë statistikorë dhe të shpërndarjes për secilën variabël, si dhe masat e asimetrisë dhe të shpërndarjes normale.

- Vlerat minimale (**Maks**),
- Vlerat maksimale (**Min**)
- Mesatarja aritmetikore (**Ma**),
- Devijimi standard (**Ds**) dhe
- Parametrat e asimetrisë (**SKEW dhe KURT**).

**Raportet e ndërlidhjeve** ndërmjet ndryshoreve të karakteristikave morfologjike, lëvizore bazike dhe motorike situacionale në hapësirën manifeste, si dhe korrelacionet ndërmjet sistemit të ndryshoreve.

**Për percaktimin** e relacionit dhe ndikimit ndërmjet ndryshoreve prediktore (karakteristikave morfologjike dhe lëvizore bazike) dhe ndryshoreve kritere (ndryshoreve situacionale) është aplikuar **analiza regressive** në hapësirën manifeste.

## **5. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUTIMI**

### **5.1. PARAMETRAT THEMELOR STATISTIKOR TË PARAMETRAVE ANTROPOMETRIK, LËVIZORE BAZIKE DHE SITUACIONALE HENDBOLLISTËT E RINJË AKTIV DHE JOAKTIV TË MOSHËS 14-15 VJEÇE**

Në tabelën 1 është paraqitur analiza deskriptive e ndryshoreve antropometrike, motorike bazike dhe situacionale te nxënësit SHMU "Skënderbeu" në Përlepnicë, Komuna e Gjilanit. Mostra ka përfshirë grupin 30 nxënëse të gjinisë mashkullore të moshës 14 -15 vjeçare, ku janë të paraqitura vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, koeficienti i variacionit, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – asim, asimetri) dhe shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet). Interpretimi i rezultateve do të bëhet së bashku me interpretimin e garfikoneve të paraqitura nën tabelë.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores antropometrike, lartësia e trupit (ALARTË) (Tabela 1) është 162.2 cm. Rezultati minimal (146 cm) dhe ai maksimal (180 cm). Rezultatet tregojnë se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores antropometrike, gjerësia e krahëve (AGJEKR) është 165.13 cm. Rezultati minimal (147 cm) dhe ai maksimal (184 cm). Rezultatet tregojnë se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores antropometrike, gjatësia e shuplakës (AGJASH) është 19.75 cm. Rezultati minimal (17.4 cm) dhe ai maksimal (22 cm). Rezultatet tregojnë se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores antropometrike, gjerësia e shuplakës (AGJESH) është 21.74 cm. Rezultati minimal (16.60 cm) dhe ai maksimal (22 cm). Rezultatet tregojnë se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores antropometrike, gjatësia e këmbës (AGJKËM) është 95.46 cm. Rezultati minimal (84.00 cm) dhe ai maksimal (107.00 cm). Rezultatet tregojnë se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores antropometrike, gjatësia e shputës (AGJKËM) është 25.36 cm. Rezultati minimal (22.30 cm) dhe ai maksimal (28.00 cm). Rezultatet tregojnë se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores lëvizore bazike, kërcim së gjati nga vendi (MKGJVE) është 233.56 cm. Rezultati minimal (180.00 cm) dhe ai maksimal (270.00 cm). Rezultatet tregojnë se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar.

